



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 31-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 28.05. 2020, në Gjimnazin “Ulpiana” me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Arif Miftari, anëtar
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Shkelzen Bislimi, anëtar
20. Albulena Kelmendi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtare
25. Bashkim Budakova, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtare
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtare
30. Arben Salihu, anëtar
31. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
3. Avni Olluri, drejtor i DA

4. Bekim Shabani, drejtor i DEZH-së
5. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
6. Emina Rexhiq, drejtoreshë e DPU
7. Rasim Hasani, drejtor i DSHP
8. Imer Rrustemi, drejtor i DI,
9. Elmaze Behluli, drejtoreshë e DKA-së
10. Anila Reçica, drejtoreshë e DRKS
11. Merita Bytyqi, drejtoreshë DSHMS
12. Islam Kaleshi, zyra ligjore
13. Semir Gashi Drejtori i Shkollës
14. Idriz Krasniqi, zv drejtor i shkollës.
15. Besart Troshupa, zyra e informimit
16. Bestar Ibrahim, zyrtar i teknologjisë
17. Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit, hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe ju tha uroj që ju të jeni mirë dhe familjet e juaja.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 28 të, mbledhja e 29-të urgjente e mbajtur në formë elektronike dhe mbledhja e 30-të e jashtëzakonshme e Kuvendit.
2. Raporti vjetor Janar-Dhjetor 2019 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale.
3. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Mars 2020.
4. Propozim rregullorë për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit
5. Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKS-së.
6. Propozim vendim për shpalljen e z. Halil Kastratit "Qytetar nderi"
7. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare për punëtorët e komunes së Lipjanit që kanë punuar në teren gjatë pandemisë COVID-19

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, pyeti se a ka dikush vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Imri Ahmeti, Kryetari i Komunës tha se i kam për të shtuar edhe dy pika shtesë e të cilat i lexoi në vazhdim.

Propozim vendim për shpalljen e z. Halil Kastratit qytetar nderi i Komunës së Lipjanit.

Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare për punëtorët e komunës së Lipjanit që kanë punuar në teren gjatë pademisë Covid-19.

Pastaj kryesuesi pyeti të pranishmit se a ka dikush ndonjë vërejtje rreth rendit të ditës me qenë se askush nuk u lajmërua për vërejtje apo plotësime me propozimet të cilat i dha Kryetari i Komunës, Kryesuesi e hudhi në votim rendin e ditës.

Dhe pas votimit u konstatua se me të gjitha votat prezenet u votua rendi i ditës.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se tani ia kaloj fjalën Kryetarit të Komunës, Imri Ahmetit, i cili do të na informojë rreth pandemisë Covid-19

Imri Ahmeti Kryetari i Komunës së Lipjanit, me datën 12.03.2020 është shpallur gjendje emergjente në vendin tonë dhe ne menjëherë ditën e nesërme kemi mbajtur takimin e parë dhe kemi formuar komisin e emergjencave për pandeminë Covid-19.

Po ashtu kemi marrë vendime për me i ndalu disa aktivitete. Kemi fillu dezinfektimin e objekteve publike, fetare, bus stacioneve etj. Janë formuar platformat online për nxënës, për këshilla mjekësore dhe ajo e psikologëve.

Rastin e parë me COVID-19 e kemi pasur në Janjevë ku pas vendimit të Ministrisë Janjeva ka hyrë në karantinë.

Kuvendi me datën 23 Mars ka marrë vendim për ndarjen e 50 mijë euro për ndihmë të disa familjeve.

Në oborrin e QKMF-së janë vendosur qendrat dezinfektuese.

Me datën 14. 04. 2020 është votuar pako emergjente prej 120 mijë euro.

Në Lipjan gjithsej kemi pasur 15 raste me COVID-19.

Shërbimet administrative nuk janë ndaluar asnjëherë kemi punuar me kujdestari.

Inspektorati sanitarë ka lëshuar 22 vendime për izolim.

Stacionit policorë në Lipjan i kemi dhënë në shfrytëzim 4 automjete.

Komuna e Lipjanit ka ndarë mbi 5 mijë pako për familjet në nevojë po ashtu kemi pasur bashkëpunim me Bashkësinë Islame, Kryqin e Kuq, Policinë si dhe shumë donator të cilët na kanë përkrahur dhe i falenderojmë për bashkëpunimin. Po ashtu deshta të ju falenderoj të gjithë ata që kontribuan siç janë asambleistët stafi mjekësorë, stafin emergjent, Kryqin e Kuq për bashkëpunimin që kemi pasur.

Shkelzen Bislimi, kam disa pyetje e para për drejtoreshën e DKA-së sa po mbahet mësimi online në Lipjan?

A do të hapen aplikacionet për subvencione të bujqësisë nga komuna e Ministria a keni ndonjë informatë. Dhe një pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë rreth një aparature për matjen e sheqerit e cila është jashtë funksionimit a e keni shikuar mundësinë që të rifunksionalizohet.

Egzona Bytyqi, së pari ju uroj që të gjithë të gëzoni shëndet të plotë ndërsa të prekurve ju uroj shërim sa më të shpejtë. Po ashtu deshta me i falënderu të gjithë ata që kontribuan në çfardo forme gjatë pandemisë COVID-19. Uroj që kohën sa kemi qenë në karantinë kemi promovu paqe, respekt për njëri-tjetrin. Pandemia ka shkaktuar probleme të mëdha për bujqit të cilët nuk kanë mundur që produktet e tyre t'i shesin dhe ne si grup i PDK-së pyesim se komuna a ka procedurë rrethana lehtësuese për këtë kategori. Po ashtu një problem tjetër ka qenë qentë endacak e për të cilët pres nga drejtori përgjegjës të na njoftoj. Për fund dje kemi marrë një lajm të mirë për hyrjen në superligën e futbollit të KF "Arbëria" nga Dobroja e për të cilën tani do të kemi përgjegjësi shtesë. Ku ju uroj suksese dhe pres që të na bëjnë krenar edhe më tutje.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, sa i përket qenëve endacak është kontrakti nga niveli qendror dhe kjo është kompetencë e nivelit qendrorë dhe shumë shpejt fillon me u implementu. Ndërsa ne kemi një projekt (sillu mirë me qentë) ku janë vendosur pikat ushqyese për qenët endacak. Stadiumi në Dobroja unë kur kam filluar të investoj jam kritikuar nga opozita. Ndërsa tash që ka hyrë "Arbëria" në super ligë më thojnë që duhet të investoj.

Sa i përket bujqësisë, dëmet e shkaktuara është kompetence e nivelit qendror.

Lulzim Rrustemi, gjatë pandemisë në Lipjan kemi kaluar mirë ku duhet falenderuar të gjithë ata të cilët kanë kontribuar. Unë kam një kërkesë që të kemi një raport të shkruar për kohën e pandemisë. Dhe kërkesa e dytë është për shërbimet publike rreth lumit "Janjevka" të ketë një segment të kanalizimit të rruga 4 korsi.

Bashkim Budakova, sa ka mundur të zhvillohet mbarëvajtja e mësimi online në komunën tonë si dhe fëmijëve të cilët nuk kanë pasur laptop apo telefon të mençur a është punuar që të ju sigurohen këto mjete. Pyetja e dytë sa është marrë komuna me trajtimin e qenëve endacak gjatë kohës së pandemisë.

Ramiz Qeriqi, edhe unë ju uroj hyrjen në super ligë KF “Arbërisë” dhe unë pata kërkuar renovimin e atij stadiumi. Pse nuk po ndihmohet KF “Lipjani” kur dihet që ky klub është formuar për t’i ruajtur vlerat që i ka pas KF Ulpiana, e ku të gjithë janë futbollist të Lipjanit.

Kam një shqetësim për një firmë “Auto Polir” ku gjatë punimeve janë dëmtuar disa mure po ashtu ajo firmë punon me kemikale.

Po ashtu një lokal “Idea Kafe” të cilit ne ja kemi dhënë lokalin ka filluar ta zë edhe ballkonin ku po i pengon qytetarët po ashtu ka filluar edhe mbjelljen e disa drunjëve dekorativ.

Albulena Kelmendi, së pari kam një falenderim për të gjithë qytetarët e komunës së Lipjanit që kanë treguar një vetëdije të jashtëzakonshme gjatë kohës së pandemisë. Gjatë rekomandimit të masave të IKSHP-së.

Pandemia na ka prurë në shkollë ku kisha kërkuar që pas përfundimit të seancës të gjithë së bashku të ja hedhim një sy shkollës ku tani gjindemi Gjimnazit “Ulpiana” dhe të shikojmë kushtet ku mbajnë mësim 1500 nxënës të kësaj shkolle.

Kolegët e mi të kësaj shkolle po thuaj se 96% ju kanë përgjigjë mësimi online. Kërkoj një raport nga DKA-ja për mësimin online gjatë kohës së pandemisë. Po ashtu kam një pyetje për drejtoreshen e shëndetësisë ku është një ankesë e qytetarëve për QKMF në Shalë në të cilën pas orës 17,⁰⁰ aty nuk ka mjek.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, pajtohem me Albulenën që të gjithë së bashku ta vizitojmë shkollën dhe t’i shohim të metat që i ka kjo shkollë. Unë e kam mbështetë KF “Arbërinë” “Ulpianën” dhe “Minatorin” dhe do t’i mbështes prap por do ta mbështes edhe çdo klub tjetër që ka për qëllim sportin.

Elmaze Behluli, unë kam planifikuar që të dal me një informatë rreth mësimi gjatë kohës së pandemisë por do të ju informoj pak tash në pika të shkurta. Mësimi online është zhvilluar për të gjitha lëndët nga klasa 0-9 dhe 10-12 në RTK. Kemi pasur mungesë të paisjeve por na ka ndihmuar stafi i shkollës “Ismajl Luma” së bashku me drejtorin Driton Sadiku po ashtu kemi marrë donacion nga Elkos grup 17 llaptop. Në përgjithësi mësimi online prej 0 deri 9 është zhvilluar 89% ndërsa prej 10 deri 12 është mësuar 96%.

Merita Bytyqi, sa i përket shëndetësisë ne gjatë pandemisë COVID-19 i kemi ndërmarrë masat menjëherë dhe jemi të kënaqur me stafin shëndetësorë për punën të cilën e kanë kryer.

Aparati të cilin e përmendi asambleisti për momentin është jashtë funksionit por do ta shohim mundësinë për ta rifunksionalizuar.

Nuk ka pasur mungesë të stafit mjekësorë as në Shalë e as ndonjë vend tjetër ata të cilët e kanë sabotu punën ne i kemi ndërmarrë masat.

Ganimete Qeriqi, kam një propozim që për fshatrat Shalë, Krojmir, Resinovc, Baicë të ketë një auto ambulancë pasi që ajo pjesë është më largë nga komuna dhe ka nevojë për një auto ambulancë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, një falenderim të veçantë për punëtorët shëndetësorë të cilët kanë qenë heronjë gjatë kësaj pandemie. Kam një pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë si do të menaxhohet çështja e vaksinimit të nxënësve nga klasa e 1 deri në 9. A ka ndonjë plan si t’i informoni prindët për këtë obligim shëndetësorë.

Egzona Bytyqi, e para siç na ftoj neve Albulena për ta vizituar shkollën e ftoj unë që të vijë dhe ta vizitoj QKMF-në në Shalë dhe ta shoh punën prej 12 orëve të cilën e bëjmë ne. E dyta nuk janë ankuar qytetarët por është ankuar një aktivist i VV i cili e ka demantuar lajmin ende pa kaluar 24 orë.

Ramiz Qeriqi, KF “Lipjani” është i regjistruar si OJQ në Ministri dhe ky klub është formuar për t’i ruajtur vlerat që ka pasur KF “Ulpiana”.

Po ashtu kompania për mirëmbajtjen e parqeve thuhet që do t’i ketë 3 punëtorë e i ka vetëm 2 punëtorë.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, ju ftoj Luan që të bëheni një komision prej 3-4 personave dhe të dilni ta shikoni se a i ka kjo kompani 3 punëtorë apo më shumë. Nuk mundemi na me i barazu KF “Arbëria” “Minatori” me klubet që janë formuar tani.

Sa i përket auto ambulances për Shalë pajtohem dhe është e nevojshme.

QKMF në Shalë është prej më të mirave që i kemi në Lipjan.

Merita Bytyqi, sa i përket çështjes së vaksionimit kur të marrim leje nga institute ne do të fillojmë me vaksionimin.

Afrim Miftari, rruga Lipjan-Banullë është mirë që është punuar por a do të ketë ndonjë projekt për rreth rrotullimin.

Albulena Kelmendi, pyetja ime ke shumë e kuartë dhe nuk pata qëllim me e akuzu askend. Thjesht kërkoja një informatë.

Ramiz Qeriqi, unë e pata fjalën për kompaninë e El-ing nga Podujeva e cila para një viti e gjysmë ka punuar vetëm me dy veta.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, ne kemi kompani të cilat kërkojnë punëtorë dhe çdo qytetarë i cili është i pa punë mund të vijë te ne dhe ne mund ta sugjerojmë te këto kompani për punë.

Rruga Lipjan-Janjevë është punuar nga Ministria por ka filluar edhe piketimi te rreth rrotullimi.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja 28 - 29 dhe e 30-të të Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ramiz Qeriqi, tha se unë kam vërejtje te ekstrakti pasi që më është shënuar mbiemri me ë- Qëriqi e duhet të jetë Qeriqi.

Arben Salihu, ka një gabim teknik te raporti vjetor Janar-Djetor i punës së zyrës së Kryetarit, në vend të 2029 duhet të jetë 2019.

Meqë vërejtje tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktet nga procesverbali i mbledhjes 28- 29 dhe 30 dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për

Aprovoi

Ekstraktet nga mbledhja e 28-29 dhe 30-të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Raporti vjetor Janar-Dhjetor 2019 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti .

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, kërkoj falje që po diskutoj jashtë temës por e nderuara doktoresh është mirë së pari me bë një padi për shpifje nadaj subjektit tënd.

Nazmi Krasniqi, unë do të ndalem te arsimi ku ka qenë një vit i mirë por jo edhe i suksesshëm kur po i shohim rezultatet ku te testi i semimaturës se kanë kaluar as 50%. Po ashtu te cikli 1 deri 9-të kemi shumë nxënës të pa notuar, gjithashtu duhet të ju bëhet një zgjidhje numrit të madh të nxënësve nëpër klasa në qytet.

Në Lipjan nuk kemi ende asnjë shkollë e cila mbanë mësim tërë ditore.

Për komunitetin serb në këtë raport nuk ka asgjë të shënuar po ashtu as për ekonominë e shkollës.

Lulzim Rrustemi, një raport i ristrukturuar mirë nëpër drejtori dhe sektore. Në këtë raport përveq sukseseve ka pasur edhe neglizhencë por nuk janë paraqitur edhe sfidat. Ky buxhet ka pasë mundësi të shfrytëzohet edhe më mirë. Te të hyrat vetanake kemi rënje të të hyrave. Po ashtu edhe te investimet kapitale kemi një shumë të madhe të pa shfrytëzuar. Kemi disa projekte në vitin 2019 të cilat kanë zero shfrytëzim, po ashtu edhe zhagjitje të disa projekteve. Te drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim nuk kemi të shënuar asnjë fjali për zonën komerciale në Babush, “Kërçevë”, Kleçkë e as te QMI-ja, e as nuk kemi kriju kushte për rritjen e numrit të punësuarëve. Ka edhe rënje të të hyrave nga qiraja publike. Në arsim sfidë është mbajtja e mësimit tërë ditorë, po ashtu edhe rezultate e dobëta të testit të semimaturës dhe maturës.

Te urbanizmi si sfidë mbetet hartimi i hartave zonale, po ashtu në objektet shumë katëshe a ka hapësirë gjelbërimi a ka shkallë ndihmëse etj.

Po ashtu në këtë raport mungon numri i punëtorëve kontratë mbi vepër.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, te kontratat mbi vepër janë të shënuara në raport.

Te buxheti plani është realizu dhe tejkalu dhe jemi ndër komunat e rralla që i kemi rritë të hyrat vetanake vit pas viti.

Shpenzimi buxhetor është bërë në përputhje me agjendën.

Kemi punë që kanë mbetur në gjysmë siç është rrethoja te “Vëllëzërit Frashëri” ku kontraktori ka qenë i pa përgjegjshëm dhe ne ja kemi ndërpre punën.

Te zonat ekonomike ka filluar puna po bëhet infrastruktura dhe pres që vitin e ardhshëm me përfundu puna në zonën ekonomike në Kërçevë.

Ne kemi fillu shpërndarjen e shportave dhe do të shpërndahen në çdo lokalitet.

Ka filluar projekti i ujësjellësit me CDI-në për zonat Kraishtë, Ribarë, Topliqan. Do ta shohim mundësinë për orëmatës edhe për fshatrat Kojskë dhe Rubovc.

Arsimi nuk është edhe keq tani më nuk po flasim për mungesë të shkollave por kemi filluar të diskutojmë për mësim tërë ditorë.

Hyra Bytyçi, në emër të grupit parlamentar të LDK-së shprehim vlerësimin tonë lidhur me raportin vjetor të punës së zyrës së Kryetarit për vitin 2019. Në këtë vit komuna jonë është vlerësuar lartë nga organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare siç janë USAID-i, DEMOS dhe MAPL-ja ku vlerësimet janë marrë në fushat e transparencës, menaxhimit financiar dhe ate konkures. Ky vit është karakterizuar me rritje të të hyrave vetanake, te tatimit në pronë, rritje të investimeve kapitale dhe rritje të subvencioneve e sidomos në bujqësi ku kemi marrë mbështetje edhe nga organizatat tjera si KATAR-i, ASB-ja, ADK-ja etj.

Në emër të grupit e falënderojmë Kryetarin dhe ekzekutivin për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme po ashtu i inkurajojmë që të vazhdoj me dinamikën e punës në mënyrë që të tejkalohen sfidat me të cilën e kanë karakterizu punën një vjeçare.

Lumturije Bytyqi-Hasani, janë disa të meta në shëndetësi të cilat komuna nuk ka mund me investu siç janë investimi në maternitet, ku qëllimi ka qenë rritja e numrit të lindjeve. Po ashtu AMF në Smallushë dhe Banullë janë të mbyllura dhe jo funksionale. Mungesa e ashensorit në QKMF po shkakton probleme. Recepcioni e ka humb kuptimin në QKMF pasi që tani aty pacientat kontrollohen në bazë të numrave dhe nuk mundet të shkoj te doktori i cili është kontrolluar më herët.

Albulena Kelmendi, te DKA ka shumë sfida por unë do t'i përmendi vetëm tri. E para arsimtarët e gjuhës Gjermane. E dyta pushimi i lehonisë te mësimdhënëset ku për këtë kam një propozim ata të cilët konkurojnë për mësim dhe nuk pranohen me i mbajtë listat e tyre dhe ata me i zëvendësu këto që shkojnë në pushim. Dhe e treta mungesat e nxënësve në shkolla.

Bashkim Budakova, më shumë do të merrem me çështjen e arsimit ku kemi suksesin e dobët të nxënësve po ashtu të testit të arritshmërisë dhe testit kombëtar që i bije se arsimi nuk është menaxhuar mirë.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, sa i përket AMF-ve do të shikohet mundësia e rifunksionalizimit të tyre. Po ashtu është shkikuar mundësia e liftit, në QKMF.

Pushimet e lehonisë nuk është e lehtë por do ta shihim mundësinë sipas bazës ligjore duhet të veprojmë. Duhet bërë një zgjidhje ligjore dhe praktike.

Me që diskutime të tjera rreth kësaj pike nuk pati, u kalua në pikën e tretë të rendit të ditës.

III

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Mars 2020.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit, drektpr i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Me që diskutime të tjera rreth kësaj pike nuk pati, u kalua në pikën e radhës të rendit të ditës.

IV

Propozim rregullore për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Elmaze Behlulit , drejtoreshë e DKA-së,e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyq-Hasani, kjo Rregullore është e mirëpritur nga të gjithë unë e përkrahi, vërejtjet e mia i kam dhënë edhe në KPF. Neni 5 duhet të hiqet dhe mendoj që nuk duhet të lihet në diskrecionin e Kryetarit se sa bursa dhe çfarë shume duhet të jetë.

Po ashtu te neni 8 pika 1.6 është e pa kuptim dhe propozoj që të hiqet kjo pikë. Po ashtu nuk pajtohem te neni 9 pika 3. Dhe kam një propozim për fund që këtë vit të ndahen bursa për të gjithë studentët.

Alban Salihu, kam një propozim te neni 6 te komisioni të jetë një anëtarë nga Kuvendi respektivisht nga opozita.

Majlinda Sylejmani, në emër të grupit parlamentar të LDK-së e përkrahim këtë propozim Rregullore. Është një mundësi e mirë që po ju ofrohet ndihmë financiare studentëve të dalluar të komunës sonë dhe shuma prej 40 mijë euro shpresojmë të rritet në të ardhmen.

Shkelzen Bislimi, një Rregullore e vonuar unë kërkoj një sçarim te neni 8 pika 1.4.

Arben Salihu, kam dy propozime që te neni 9 pika 1.10 ku thuhet fëmijët që nuk i kanë dy prindërit në jetë të jetë njërin prind apo të dy prindërit. Po ashtu te hyjnë edhe fëmijët e martirëve të luftës këtu ku janë të veteranëve.

Fehmi Rexhepi, ne e përkrahim këtë Rregullore por studentët e komunitetit ashkali nuk kanë mundësi për t'i vazhduar studimet dhe do të ishte mirë që me u vlerësu me 5 pikë më shumë.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, këtë vit janë të parapara 40 mijë euro për bursa. Martirët i kemi vlerësuar me 10 pikë. Pajtohem që komunitetit jo shumicë të ju shtohen 10 pikë, ndërsa sa i përket komisionit nga Kuvendi kompetencat janë të ndara në mesë të ekzekutivit dhe legjislativit, por ju si legjislativ mund të merrni pjesë kur të dëshironi në mbledhje të komisionit.

Pajtohem që të hiqet te neni 8 pika 1.6 . Po ashtu te neni 9 të jetë fëmija të cilin nuk e ka njërin apo dy prindërit në jetë.

Ramiz Qeriqi, e përkrahi këtë propozim Rregullore por kërkoj një sqarim këtu ku thuhet fëmijët e dëshmorëve, fëmijët e martirëve ata tani janë të rritur apo ju ndoshta e keni fjalën për nipat e tyre nëse ka mundësi me ma sqaru.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, ka fëmijë që i ka 20 vjetë por ndoshta tani e regjistron fakultetin.

Afrim Miftari, ne në KPF i kemi dhënë propozimet sa i përket kësaj Rregullore dhe kjo Rregullore ka për qëllim që të përfitojnë studentët e Lipjanit. Kam një propozim që shuma të jetë 500 deri 600 euro për student po ashtu kam një propozim që vitet e ardhshme studentët të cilët e dëshmojnë se e kanë fituar kushtin të ju ipet bursa automatikisht.

Egzona Bytyqi, unë e përkrahu këtë propozim Rregullore kam propozim që te neni 9 të përfshihen edhe studentët të cilët kanë ndonjë çertifikatë në nivel ndërkombëtarë. Po ashtu te neni 2 të shtohet komuna në bashkëpunim me donatorët.

Alban Salihu, i kuptoj dallimet në mes legjislativit dhe ekzekutivit por gjatë shiqimit të Rregulloreve të disa komunave tjera e pashë se në komision kanë qenë të përfshirë edhe anëtarët nga legjislativi dhe shoqëria civile.

Nehat Tërpeza, unë kisha propozu që përveq univerziteteve publike të përfshihen edhe ato private.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren me këto ndryshime që te neni 8 pika 1.6 të hiqet krejt, te nenin 9 pika 1.10 të shtohet studentët të cilët nuk e kanë njërin apo të dy prindërit. Po ashtu të shtohet edhe neni 1.11 studentëve të komunitetit jo shumicë të ju shtohen 10 pikë dhe hiqet pika e tretë e nenit 9. Kryesuesi vuri në votimit dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 30 votat për, aprovoi këtë:

RREGULLORE PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË LIPJANIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet, kriteret, kohëzgjatja e realizimit të bursës, dhe procedura për ndarjen e bursave për studentë, të cilët studiojnë në Universitetet publike të Republikës së Kosovës.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Komuna e Lipjanit, varësisht nga mjetet financiare që ka në dispozicion, ndanë bursa për studentë të Komunës së Lipjanit.
2. Bursat ndahen për periudhën kohore nga 1 tetori deri më 30 shtator të vitit vijues akademik-shkollor.

Neni 3 Përfituesit e bursës

1. Të gjithë studentët, pa dallime etnike, gjinore, racore, fetare, sociale dhe politike, që janë të regjistruar në universitetet publike të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar studentët në studime pasuniversitare – master dhe doktoraturë, kanë të drejtë të konkurojnë për marrjen e bursave për studime.
2. Përparësi në fitimin e së drejtës për bursë do të kenë studentët që studiojnë në drejtime deficitare.
3. Drejtimet deficitare përcaktohen sipas thirrjes publike për aplikim nga ana e Drejtoratit për Arsim.
4. Numri i bursave publikohet në thirrjen publike për aplikim për të gjitha kategoritë.

Neni 4 Përfituesit e bursës me automatizëm

Fëmijët e Dëshmorëve që studiojnë në Universitetet publike të Republikës së Kosovës, bursën e përfitojnë me automatizëm çdo herë kur Komuna shpallë thirrje publike për ndarjen e bursave për studentë dhe të njëjtit duhet të aplikojnë me dokumentacionin e kërkuar sipas thirrjes publike të shpallur nga Komuna.

Neni 5

Numri i bursave

Kryetari i Komunës me vendim cakton numrin e bursave që do të ndahen dhe shumën financiare për një bursë që ndahet për një vit akademik - shkollor.

Neni 6

Formimi dhe përbërja e komisionit

1. Bursat për studentë do të ndahen nga komisioni i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës.
2. Komisioni do të jetë i përbërë nga 3 anëtarë që duhet të jenë shërbyes civil të administratës komunale, dy anëtarë nga Drejtorati i Arsimit, një anëtar nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa.
3. Punët teknike administrative të nevojshme për komisionin, pranimi i kërkesave/aplikacioneve, formulimin e vendimeve apo kontratave për përfituesit do të kryhen nga Drejtorati i Arsimit.

Neni 7

Shpallja e thirrjes publike

1. Drejtorati i Arsimit shpallë thirrjen publike për ndarjen e bursave. Thirrja publike duhet të jetë e shpallur në ueb faqen zyrtare të Komunës, në njërën nga gazetatat ditore si dhe në tabelën e shpalljeve dhe duhet të jetë e hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit.
2. Në thirrjen publike për aplikim për burs duhet të përcaktohet dokumentacioni i kërkuar dhe informatat tjera të nevojshme.

Neni 8

Kushtet dhe kriteret

1. Për realizimin e të drejtës së bursës kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:
 - 1.1. Të jenë banorë rezident të Komunës së Lipjanit,
 - 1.2. Të kenë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa,
 - 1.3. Të kenë certifikatën e notave,
 - 1.4. Të mos jenë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër për vitin e njëjtë akademik,
 - 1.5. Të mos jenë të punësuar,

Neni 9

Kriteret për përfitimin e bursës

1. Të gjithë studentët, pa dallime, që studiojnë në Universitetet publike të Republikës së Kosovës e që kanë aplikuar për fitimin e bursës do të vlerësohen për sukseset e arritura në mësimet e studimeve të vitit paraprak me pikë si në vijim:
 - 1.1. Studenti/ja me notë mesatare mbi 9 (nëntë), vlerësohet me 30 pikë,
 - 1.2. Studenti/ja me notë mesatare mbi 8 (tetë), vlerësohet me 20 pikë,
 - 1.3. Studenti/ja me notë mesatare mbi 7 (shtatë), vlerësohet me 15 pikë,
 - 1.4. Studenti/ja me notë mesatare mbi 6 (gjashtë), vlerësohet me 5 pikë,
 - 1.5. Studenti/ja me nevoja të veqanta vlerësohet me 10 pikë,
 - 1.6. Studenti/ja me asistencë sociale vlerësohet me 10 pikë,
 - 1.7. Studenti/ja me studime në drejtimit deficitare vlerësohet me 10 pikë (drejtimeve deficitare që mund t'u jepet përparësi përcaktohen në thirrjen publike për aplikim nga Drejtorati për Arsim),
 - 1.8. Studenti/ja fëmijë i martirëve, veteranëve, invalidëve vlerësohet me 10 pikë,
 - 1.9. Studenti/ja që studion së bashku me një anëtar nga familja e ngushtë vlerësohet me 10 pikë,
 - 1.10. Studenti/ja që nuk e ka njërin apo dy prindërit në jetë vlerësohet me 10 pikë.
 - 1.11. Studenti/ja që i përket komunitetit jo shumicë vlerësohen me 10 pikë.

2. Studentët që kanë pikë të barabarta, përparësi në renditjen e listës të shpallur nga komisioni për ndarjen e bursave, do t'i jepet studentëve që kanë notën mesatare më të lartë.

Neni 10 **Detyrat e komisionit**

Pas skadimit të afatit të konkurimit komisioni do të bëjë vlerësimin e aplikacioneve. Gjatë procedurës së vlerësimit të aplikacioneve, komisioni do të përcaktojë metodën e punës dhe mënyrën e seleksionimit të aplikacioneve, gjithnjë duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas kësaj Rregullorje.

Neni 11 **Hartimi dhe publikimi i listës së përfituesve të bursës**

1. Pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të aplikacioneve, komisioni për ndarjen e bursave harton listën e përgjithshme përfundimtare të kandidatëve përfitues të bursës.
2. Lista përfundimtare e përfituesve shpallet në ueb faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.

Neni 12 **E drejta e ankesës**

1. Kundër vendimit për shpalljen e listës përfundimtare të përfituesve të bursave nga komisioni për ndarjen e bursave, lejohet ankesa e cila i drejtohet komisionit të ankesave i formuar ad-hoc me vendim të Kryetarit të Komunës.
2. Ankesa ushtrohet në afat prej tetë (8) ditëve nga dita e shpalljes së listës së përfituesve nga ana e komisionit.
3. Komisioni për shyrtime të ankesave, në afat prej 15 ditësh duhet të shqyrtojë dhe të vendos lidhur me ankesat e ushtruara.
4. Vendimi i komisionit të ankesave është përfundimtar në procedurë administrative.

Neni 13 **Nënshkrimi i aktit për ndarjen e bursës**

1. Kryetari i Komunës pas përfundimit të procedurave të ankesave nënshkruan vendimin për secilin përfitues për marrjen e bursës në shumën e caktuar paraprakisht sipas thirrjes publike të shpallur nga Drejtorati për Arsim, në bazë të aplikacioneve individuale të tyre.
2. Nëse ndonjëri nga përfituesit e bursës hjekë dorë nga përfitimi i bursës për arsye të ndryshme, atëherë përfituesi i bursës do të jetë kandidati/ja që është në radhë sipas listës.

Neni 14 **Procedurat e pagesës**

1. Mjetet financiare do të alokohen gjatë vitit fiskal në xhirollogaritë bankare të përfitueseve, në bankën të cilën studenti/ja e ka zgjedhur.
2. Drejtoratet kompetente për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Arsim janë të obliguar të kujdesen për alokimin dhe zotimin e mjeteve të cekura më lartë brenda afateve të përcaktuara kohore.

Neni 15 **Përgjegjësia për zbatim**

Përgjegjes për zbatimin e kësaj Rregullore është Drejtorati për Arsim në Komunën e Lipjanit.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Dispozitat kalimtare

Çdo dispozitë e kësaj Rregulloreje që bie ndesh me ligjet në fuqi epërsi do të kenë për zbatim dispozitat ligjore.

Neni 17

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare elektronike të Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregulloreja për ndarjen e bursave për studentë, 1Nr.11/2003-2 e datës 25.09.2003 si dhe Rregullorja 1Nr.67-304 e datës 10.10.2007, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Rregullorës për ndarjen e bursave, 1Nr.11/2003-2 e datës 25.09.2003.

Shtesë: Rregullorja.

V

Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB-së.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Nazim Gashit, drejtor i DMSH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Megjë diskutime rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 27 votat për, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI –KKSB-së

Neni 1

Zëvendësimi i anëtarëve të KKSB-së

1.Me këtë Vendim zëvendësohet tre anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të caktuar sipas pikës I të Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSB në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-67926 të datës 22.12.2017 ashtu :

1.1 Z.Xhevdet Bytyqi nga Bashkësia Islame në numrin rendor 3 zëvendësohet nga Mr. **Zaim Bahtiu**,

1.2 Z.Ylber Reqica nga OJQ “Polis” në numrin rendor 6 zëvendësohet nga Z.**Muhamet Qeriqi**,

1.3.Rasim Hasani, ish-Drejtor i Drejtoratit për Arsim tani drejtor i DSHP-së në numrin rendor 14 zëvendësohet nga Drejtoresha e Drejtoratit për Arsim Znj. **Elmaze Behluli** .

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të KKSB-në është i përcaktuar me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSB në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-67926 të datës 22.12.2017.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VI
Propozim vendim për shpalljen e z. Halil Kastratit Qytetar nderi

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 26 votat për, aprovoi këtë:

V E N D I M
PËR SHPALLJEN E Z. HALIL KASTRATIT, QYTETAR NDERI I KOMUNËS SË
LIPJANIT

Neni 1

Z. HALIL KASTRATI, Kryetar i Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” shpallet **QYTETAR NDERI I KOMUNËS SË LIPJANIT**.

Neni 2

Me rastin e shpalljes Qytetar Nderi i Komunës së Lipjanit pas miratimit të këtij Vendimi, Kryetar i Komunës së Lipjanit, do të ia dorëzojë solemnisht Z. Halil Kastratit dekoratën “QYTETAR NDERI” I KOMUNËS SË LIPJANIT”

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VII
Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare për punëtorët e komunës së
Lipjanit që kanë punuar në teren gjatë pandemisë COVID-19

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Alban Salihu, fillimisht nuk është praktikë e mirë me ardh pikat e rendit të ditës, ditën e mbajtjes së Kuvendit pasi që Kryetari së bashku me Kryesuesin e Kuvendit e përpilojnë rendin e ditës. Ne si grup i LVV-së votojmë kundër këtij propozimi pasi që këta i kanë marrë pagat e tyre dhe do të ishte mirë që ato mjete të shkojnë në bujqësi apo te ndonjë sektor tjetër.

Imri Ahmeti, ne kemi drejtë me propozu pika shtesë dhe Kuvendi vendos nëse don me vazhdu tutje ose jo.

Pagat e veta i kanë marrë edhe disa sektor tjerë të cilët nuk janë dalë asnjëherë në vendin e tyre të punës. Është jo korrekte me i barazu ata të cilët nuk janë ardh kurë me këta të cilët kanë punu edhe të shtoneve edhe të dieleve e disa herë, deri në 10 të natës dhe nuk

është shumë e madhe e cila po ju ndahet. Konsideroj që këta punëtorë e kanë meritë këtë pagesë.

Alban Salihu, unë e vlerësoj kontributin e secilit që ka ndihmuar por kemi ndihmuar të gjithë nga pak.

Lumturije Bytyqi-Hasani, nga pako e Qeverisë kanë përfituar ata të cilët kanë dalë në punë të pakten një ditë por janë diskriminuar punëtorët teknik dhe ata të administratës të cilët punojnë në shëndetësi dhe do të ishte mirë komuna me i shti në listë edhe këta punëtorë.

Nehat Tërpeza, e përgëzoj Kryetarin për propozimin, unë i kam parë këta punëtorë punën të cilën e kanë bërë në teren bile e kam prit që lista të jetë edhe më e gjatë. Kjo ekip meriton edhe mirënjohje pas pandemisë.

Ramiz Qeriqi, këta punëtorë e meritojnë të paguhën pasi që e kanë rreziku veten dhe këta meritojnë të paguhën dhe të falenderohen.

Ukë Kryeziu, duhet pa tjetër të paguhën të gjithë ata që kanë kontribuar por është mirë të shikohet mundësia që edhe punëtorët teknik të shëndetësisë të përfshihen.

Albulena Kelmendi, ne si subjekt nuk jemi kundër asnjë personi i cili është në atë listë por jemi që ato mjete të shkojnë dikun tjetër.

Ganimete Qeriqi, e pashë listën e punëtorëve të cilët janë në këtë listë dhe jam që të përfshihen të gjithë punëtorët e Qendrës për Punë Sociale.

Imri Ahmeti, këta punëtorë kanë punuar punë që janë jashtë referatit të tyre. Ka punëtorë të cilët kanë punuar e nuk e kemi shti në listë siç janë Diamant Bytyqi, Avni Olluri etj.

Lulzim Rrustemi, pse vazhdimisht të njëjtit persona kanë punuar e nuk janë ndryshuar.

Meqë diskutime rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 24 votat për, 2 kundër dhe 2 apstenime aprovoi këtë:

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14,²⁰

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi